

**Würth Kosova Shpk shpallë konkurs për:**

## **TELESALES**

### **Vendi - Prishtinë**

Jemi pjesë e koncernit botëror WÜRTH-GROUP dhe njëra nga kompanitë lidere në Republikën e Kosovës. Merremi me shitjen dhe distribuimin e produkteve për auto/cargo, metal, industri të drurit dhe ndërtimit (montim dhe elemente lidhëse për prodhim industrial, vegla të ndryshme dore, vegla elektrike, motorike ose me bateri, pajisje mbrojtëse, bulona, materiale shpenzuese për industrinë automobilistike, elemente lidhëse për mobilieri dhe karpentieri, produkte teknike-kimike etj).

#### **Profili dhe cilësitë tuaja:**

Keni përvojë shitjesh dhe shkathtësi komunikimi? Keni kompetencë në fushat teknike (industrinë e makinerisë, elektroteknikës) dhe dëshironi të shkëmbeni njohuritë dhe përvojën tuaj nëpërmjet shitjes? Keni eksperiencë të mëparshme që keni përdorur ndonjë program financiar. Keni eksperiencë si shitës apo faturist në dyqane fizike?

Po kërkonte një punë sfiduese dhe posedoni karakteristikat e lartpërmendura? Atëherë, aplikoni në konkursin tonë për telesales.

#### **Njohuritë dhe shkathtësitë e dëshirueshme:**

- shkathtësi negociuese, të komunikimit dhe krijimit të raporteve biznesore
- përvojë në shitje, në punë të njëjtë apo të ngjashme, apo në ndonjërin nga veprimtaritë në industrinë auto, metal, dru dhe ndërtimtare.
- njohuri e asortimit të produkteve të cilat kompanitë i përdorin në punën e tyre të përditshme në fushat si mirëmbajtje e automjeteve dhe cargo, përpunim dhe mirëmbajtje metali, përpunim dhe mirëmbajtje druri si dhe produkte të ndryshme për përdorim në ndërtimtare.
- aftësi organizimi dhe planifikimi
- përvoja e mëparshme si shitës në dyqane apo kompani me veprimtari të ngjashme përbëjnë përparësi
- shkollim të mesëm ose universitar.



### Përgjegjësitë tuaja në Wurth:

- analiza e historikut të shitjes në regjistrin e blerjeve, analiza e borxheve, komunikimi periodik përmes telefonit, e-mail-it ose përmes rrjeteve sociale.
- Hulumtimi i tregut për blerës potencial.
- Përgatitja e ofertave, distribuimi elektronik i aksioneve dhe ofertave aktuale të shitjes.
- ofrimi i informacionit Teknik blerësve lidhur me produktet.
- Kryerja e procesit të faturimit dhe plotësimi i faturave tatimore.

### Te ne do të gjeni:

Zhvillim profesional, siguri dhe mjedis pune të shkëlqyer të nivelit ndërkombëtar, të ardhura personale që varen direkt nga performanca, angazhimi dhe suksesi juaj në shitje.



CV-në tuaj dërgojeni në adresën [info@wurth-kosova.com](mailto:info@wurth-kosova.com) më së largu deri më: **07 shkurt 2021**.

Ju do të kontaktoheni nga departamenti i burimeve njerëzore të Würth Kosova sh.p.k. vetëm nëse CV dhe dokumentet tuaja plotësuese përzgjedhen nga skuadra jonë e vlerësimit.